



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA**

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE  
NATIONAL AUDIT OFFICE**

**Nr. i Dokumentit: 24.31.1-2016-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT  
PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË KOMISIONIT TË  
PAVARUR PËR MINIERA DHE MINERALE PËR VITIN E  
PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016**

**Prishtinë, qershor 2017**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Faruk Rrahmani (Udhëheqës e kipe) dhe Fatlinda Podvorica e Albesa Ramosaj (Anëtare e kipi), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit, Emine Fazliu.

---

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	6
2 Qeverisja.....	9
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	13
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit .....	20
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	21
Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak .....	24
Shtojca IV: Letërkonfirmimi .....	26

## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit<sup>1</sup>, të datës 29.11.2016.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën 1):



Niveli i punës së kryer nga Zyra Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale.

### Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

#### Opinion i pamodifikuar


Pasqyrat Financiare Vjetore *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Për më gjerësiht shih pjesën 1.1 të këtij raporti.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Falënderojmë Kryesuesin e Bordit dhe stafin e tij mbështetës për bashkëpunimin e ofruar gjatë procesit të auditimit.

<sup>1</sup> Termi "Plani i Jashtëm i Auditimit" është zëvendësim i termit "Memorandumi i Planifikimit të Auditimit"

**Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore****Përgjigja e Kryesuesit të Bordit**

Kryesuesi i Bordit ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

# 1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

## Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

## 1.1 Opinioni i auditimit

### Opinion i pamodifikuar

Kemi audituar PFV-të e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore (OB).

### Baza për opinion

Kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

---

### **Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV**

Menaxhmenti i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryesuesi i Bordit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Organizatës buxhetore.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

---

## 1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Nga KPMM kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime);
- Pajtueshmërinë me rregullën financiare nr. 01/2013, dhe Rreg. financiare nr. 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Raportet tremujore duke i përfshirë këtu edhe pasqyrat nëntëmujore me kohë;
- Raportet për faturat e papaguara;
- Draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit; dhe
- Raportet e kontratave të nënshkruara të prokurimit.

Në draft PFV-të ishin të nevojshme disa korrigjime financiare për të cilat kemi dhënë sugjerime për të përmirësuar cilësinë e tyre. Pas sugjerimeve, KPMM ka korrigjuar PFV-të para finalizimit të tyre, për të konfirmuar saktësinë dhe plotësinë e tyre. Gjatë auditimit ne identifikuam një pasuri të paprekshme në vlerë prej 125,990€ e pranuar në vitin 2014 e cila ishte regjistruar gabimisht si investim në vijim duke ndikuar që pasuria neto të jetë e mbivlerësuar pasi që nuk ishte kalkuluar zhvlerësimi. Pas vërejtjeve tona zyrtari i pasurisë ka ndërmarrë veprimet e nevojshme dhe e ka regjistruar siç duhet në regjistrin e pasurive.

Marrë parasysh çka u tha më lart, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar me rastin e dorëzimit të PVF-ve në Qeveri, mund të konsiderohet e drejtë dhe e vërtetë.

Sa i përket kërkesave tjera të raportimit, KPMM ka arritur të dorëzoj me kohë të gjitha raportet të cilat kërkohen me kornizën e aplikueshme ligjore, me përjashtim të raporteve të barazimeve mujore të të hyrave me Thesarin. Në fund të vitit 2016, në memorandumun e auditimit ne këshilluam menaxhmentin të përmirësojnë raportimin e të hyrave. Pas pranimit të këshillës tonë, përkatësisht nga janari 2017 KPMM e kishte adresuar këtë çështje.

### **Rekomandimi**

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.



## 2 Qeverisja

### Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për KPMM-në që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, pyetësi i vet-vlerësimit që plotësohet nga KPMM siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij raporti).

### Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Në lidhje me qeverisjen e mirë ne vlerësojmë progresin e KPMM-së në hartimin e strategjisë dhe listën e rreziqeve, të cilat ishin si dokumente fillestare. Megjithëse ato duhet të avancohen më tutje duke përfshirë koston e parashikuara për aktivitetet e strategjisë si dhe indikatorët matës të tyre, dhe të fillojnë veprimet konkrete për menaxhimin e rrezikut. Po ashtu duhet të rritet niveli i zbatimit të rekomandimeve, qoftë nga auditimi i jashtëm ose ai i brendshëm.

## 2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve nga vitit paraprak

Raporti jonë i auditimit për PFV-të e vitit 2015 ka rezultuar me dhjetë (10) rekomandime. Prej tyre gjashtë (6) janë zbatuar plotësisht, një (1) ishte në proces dhe tri (3) rekomandime të rëndësishme nuk janë zbatuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë zbatuar ato, shihni Shtojcën III.

### Çështja 1 - Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

**E gjetura** KPMM ka bërë progres të theksuar në adresimin e rekomandimeve në disa fusha, mirëpo rekomandimet e dhëna në fushat kryesore nuk janë zbatuar. Rekomandimet e pa zbatuara ndërlidhen me fushat, si: mos raportimet e bartësve të licencave, vazhdimi i operimeve ilegale dhe rritja e të arkëtueshmeve nga viti në vit. Menaxhmenti së bashku me zyrtarët përgjegjës, janë duke bërë përpjekje serioze për të adresuar rekomandimet e mbetura.

**Rreziku** Vonesat në përmirësimet e kërkuara të proceseve operacionale mund të ndikojnë në mos efikasitet të vazhdueshëm duke rezultuar në:

- Raportim jo të plotë dhe vazhdim të aktiviteteve ilegale në fushën e minierave dhe mineraleve; dhe
- Rritje të vazhdueshme të arkëtueshmeve të KPMM-së.

**Rekomandimi 1** Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që plani i veprimit, duhet të rishikohet duke i analizuar shkaqet e rekomandimeve të pazbatuara dhe të përcaktojë një afat kohor për adresimin e rekomandimeve të mbetura, me anëtarët e stafit llogaridhënës dhe me fokus fillestar në fushat e një rëndësie më të madhe. Zbatimi i këtij plani duhet të monitorohet në vazhdimësi.

## 2.2 Pyetëtori i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së

MF ka hartuar një pyetësor të vet-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Për të gjitha auditimet e ndërmarra, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vet-vlerësimit të MFK-së të dorëzuara në MF, duke vlerësuar secilën komponentë të pyetësorit.

Ne kemi përmbledhur të gjeturat tona për KPMM-në më poshtë dhe përmbledhja e punës sonë në të gjitha auditimet do të konsolidohet në Raportin Vjetor të Auditimit. Kjo nuk ka për qëllim të jap koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vet-vlerësimit por do të pasqyrojë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për të mbështetur përpjekjet e MF-së në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Veprimi i ndërmarrë nga Auditimi i Brendshëm për adresimin e çështjeve të identifikuar nga pyetëtori i vet-vlerësimit i vitit 2015 ishte në progres. Kjo ka ndodhur nga fakti se këtë vit çështja e

---

vet-vlerësimin nga KPMM ishte marrë më seriozisht duke organizuar edhe takime për plotësimin e pyetësorit dhe për t'i mbështetur përmirësimet operative. Megjithëse, edhe në vitin 2016 janë identifikuar mangësi në plotësimin e tij.

---

## **Çështja 2 – Proceset strategjike dhe menaxhimi i rrezikut – Prioritet i lartë**

**E gjetura** Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar çështjet kyçe të pyetësorit të vet-vlerësimin në lidhje me pesë komponentët e tij. Bazuar në këtë kemi gjetur se:

1. Sistemet e kërkuara në lidhje me strategjinë dhe menaxhimin e rrezikut ishin në fazë fillestare. KPMM në prill të vitit 2017 kishte hartuar një listë të rreziqeve në të cilën janë identifikuar rreziqet e mundshme për fusha operative, megjithatë ende nuk kishin filluar veprimet konkrete për menaxhimin e tyre; dhe
2. Proceset strategjike konsiderohen në fazë të hershme të zhvillimit nga fakti që KPMM në fund të vitit 2016 kishte arritur të hartoj një strategji trevjeçare për vitet 2017-2019 me objektiva strategjike. Megjithatë kjo strategji nuk kishte të kalkuluar koston e parashikuara për aktivitetet si dhe nuk kishte indikator matës. Po ashtu, edhe procesi i monitorimit për nivelin e arritur të përmbushjes së objektivave strategjike, ishte në fazë fillestare.

**Rreziku** Aranzhimet e dobëta të qeverisjes i dobësojnë proceset strategjike dhe operative, për shkak se veprimet pro aktive të nevojshme për të parandaluar ose evituar ndikimin e çështjeve të tilla nuk do të ndërmerren në mënyrë të planifikuar dhe sistematike.

**Rekomandimi 2** Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se mekanizmat për zbatimin e strategjisë dhe menaxhimin e rrezikut janë vendosur plotësisht dhe operojnë në mënyrë sistematike duke siguruar raportim mujor dhe monitorim të vazhdueshëm të tyre. Rëndësi e veçantë duhet t'i kushtohet zhvillimit të procesit të menaxhimit të rrezikut në mënyrë që të parandalohen rreziqet të cilat pengojnë arritjen e objektivave të organizatës.

---

## 2.3 Sistemi i auditimit të brendshëm

Sistemi i auditimit të brendshëm është një pjesë kyçe e kontrollit të brendshëm. Ne marrim parasysh fushëveprimin e punës së auditimit të brendshëm dhe aktivitetet e komitetit të auditimit (KA). Përveç kësaj, ne i shqyrtojmë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti i lartë si rezultat i punës së kryer nga auditimi i brendshëm dhe KA. Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me një anëtar i cili është drejtor i njësisë.

NjAB në planin vjetor të auditimit për vitin 2016, kishte planifikuar gjashtë (6) auditime të rregullta. Plani ishte përmbushur në tërësi dhe raportet e AB-së ishin përmbajtësore dhe të një cilësie të mirë.

---

### Çështja 3 - Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve të NjAB-së - Prioritet i lartë

**E gjetura** Raportet e auditimit të brendshëm nuk ishin trajtuar nga menaxhmenti në nivelin e duhur, pasi që një numër relativisht i vogël i rekomandimeve ishin zbatuar.

Nga gjithsej 62 rekomandimet analitike të dhëna në gjashtë (6) raportet e auditimit 47 prej tyre ose 75% nuk ishin zbatuar, përkundër që të gjeturat nuk ishte kontestuar me komente nga ana e njësive të audituara. KA kishte mbajtur takime të rregullta, mirëpo nuk kishte dhënë ndonjë kontribut domethënës në zbatimin e rekomandimeve.

**Rreziku** Mos zbatimi i rekomandimeve të AB-së dhe trajtimi jo i duhur i raporteve të tyre, do të ketë ndikim negativ në funksionimin efektiv të kontrolleve të brendshme si dhe rritë rrezikun që gabimet dhe mangësitë e njëjta të përsëriten në vazhdimësi.

**Rekomandimi 3** Kryetari i Bordit duhet të sigurojë një bashkëpunim efektiv në mes të menaxhmentit, KA-së dhe NjAB-së për të identifikuar shkaqet e kësaj gjendje dhe për të ndërmarrë veprime konkrete për të arritur përfitimin maksimal nga auditimi i brendshëm. Më tej, Komiteti i Auditimit duhet të forcojë rolin e vet në këtë proces, duke e mbajtur menaxhmentin më përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve.

## 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

### Hyrje

Puna jonë për MFK-në jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

KPMM në përgjithësi ka kontrolle të mira në raport me obligimet statutores të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli kanë dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit.

Në vitin 2016, KPMM ka përdorur pothuajse tërë buxhetin final, që paraqet një performancë të mirë në përdorimin e buxhetit. Në anën tjetër edhe performanca në mbledhjen e të hyrave ka shënuar rritje për 4% krahasuar me vitin paraprak.

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh kyçe nëpër sistemet financiare, por që, kontrollet mbi disa fusha kërkojnë përmirësim të mëtejshëm. Fushat kryesore ku nevojiten përmirësime të mëtejme janë: mbikëqyrja më e madhe e bartësve të licencave, ndalimi i operimeve ilegale, zvogëlimi i llogarive të arkëtueshme dhe menaxhimi i pasurive.

Ne vlerësojmë se llogaritë e arkëtueshme kërkojnë vëmendjen e veçantë të menaxhmentit për të gjetur mekanizma adekuat që të shtohet efikasiteti në inkasimin e tyre. Kjo nga fakti që, të arkëtueshmet në vitin 2016 krahasuar me vitin paraprak janë rritur për 15%.

Ne inkurajojmë menaxhmentin e KPMM-së të marrë në konsideratë raportet e kryera të NjAB-së për fushat e lartcekura për të përmirësuar mangësitë e theksuara.

### 3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkasuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>2</sup>	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>1,347,368</b>	<b>1,240,763</b>	<b>1,239,655</b>	<b>1,129,637</b>	<b>1,552,999</b>
Granti i Qeverisë - Buxheti	1,347,368	1,240,763	1,239,655	1,129,637	1,552,999

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 106,605€. Me rishikim të buxhetit ishte zvogëluar për 40,740€ ndërsa me vendime të Qeverisë pas procesit të rishikimit buxhetor për 65,865€. Në vitin 2016, KPMM ka përdorur mbi 100% të buxhet final që paraqet një ekzekutim më të mirë të buxhetit për rreth 5% krahasuar me vitin paraprak. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale të buxhetit për secilën kategori.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>1,347,368</b>	<b>1,240,763</b>	<b>1,239,655</b>	<b>1,129,637</b>	<b>1,552,999</b>
Pagat dhe Mëditjet	770,487	744,619	744,619	712,787	619,388
Mallrat dhe Shërbimet	386,281	367,259	367,259	331,864	355,589
Shërbimet komunale	30,600	22,027	20,931	22,327	22,862
Subvencione dhe Transfere	-	-	-	13,000	-
Investimet Kapitale	160,000	106,858	106,846	49,659	555,160

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje ishte reduktuar me vendime të Qeverisë për 25,868€. Në raport me vitin paraprak, si rezultat i kompletimit të bordit dhe, rritjes së përvojës së punës shpenzimet në këtë kategori janë rritë për 31,832€;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte reduktuar me vendim të Qeverisë për 19,022€. Në raport me vitin paraprak shpenzimet në këtë kategori janë rritë për 35,395€. Buxheti i kësaj kategorie është shpenzuar 100%;

<sup>2</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

- Buxheti final për shërbime komunale ishte reduktuar me vendim të Qeverisë për 8,573€. Në raport me vitin paraprak shpenzimet në këtë kategori janë ulur për 1,396€. Buxheti i kësaj kategorie është shpenzuar 95%; dhe
- Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 53,142€ (me rishikim të buxhetit ishte zvogëluar për 40,740€ më tutje pas rishikimit me vendime të Qeverisë buxheti ishte zvogëluar edhe për 12,402€). Nga dhjetë (10) projektet kapitale, buxheti për shtatë (7) prej tyre ishte zvogëluar me rishikim të buxhetit. Kjo situatë e kishte pamundësuar KPMM-në që të realizoj të gjitha projektet dhe si pasojë KPMM ishte detyruar të kërkoj nga MF ridestininim të mjeteve në mënyrë që të kompletoj projektet të cilat i kishte me prioritet.

### Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

#### 3.1.1 Të Hyrat

Të hyrat e realizuara në vitin 2016 ishin 31,206,899€, që paraqet një tejkalim të planit për 1,156,899€ (vlera e parashikuar e të hyrave ishte 30,050,000€). Në raport me vitin e kaluar, KPMM ka shënuar realizim më të lartë të të hyrave për 1,065,496€, apo rreth 4%. Nga llojet e të hyrave rritja më e madhe vjen nga renta minerare prej 854,772. Në vijim do të paraqesim në mënyrë të detajuar të hyrat për nga lloji dhe vitet.

**Tabela. 3 Të hyrat e detajuara sipas llojit**

Përshkrimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
<b>Te hyrat sipas Llojit</b>	<b>31,206,899</b>	<b>30,141,403</b>	<b>26,966,930</b>
Taksa Administrative	461,722	292,390	280,705
Gjoha administrative	190,895	149,503	147,246
Renta Minerare	30,554,282	29,699,510	26,538,979

---

**Çështja 4 - Raportimi i bartësve të licencave – Prioritet i lartë**

**E gjetura** Procesi i raportimit të bartësve të Licencave është i rregulluar me Ligjin nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale i ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-158. Ne verifikuam se bartësit e licencave nuk kishin raportuar në departamentet përkatëse në KPMM qoftë me raporte tremujore ashtu edhe me ato vjetore.

Nga informatat e pranuar nga KPMM vërehet se në fund të vitit 50 kompani nuk kishin raportuar në gjeologji, 66 në financa dhe 41 kompani në gjeodezi. Prej tyre 11 ishin me licenca aktive kurse tjerat ishin me licenca të pezulluara, të anuluar ose të mbyllura. Për të gjitha kompanitë që nuk kishin raportuar KPMM kishte lëshuar aktvendimet për pezullimin e licencave

**Rreziku** Mos raportimi i rregullt nga ana e bartësve të licencës rritë rrezikun që KPMM të ketë mungesë të informatave të plota në lidhje me sasinë e mineraleve të prodhuara dhe vlerën reale të obligimeve që e ka secili bartës i licencës.

**Rekomandimi 4** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se ndërmerren veprime adekuate për të shtuar përgjegjësinë e raportimit duke ngritur efikasitetin me qëllim të sigurimit të informatave të plota lidhur me sasinë e mineraleve të prodhuara dhe aktivitetin e shfrytëzuesve të licencave, ashtu siç përcaktohet me kornizën ligjore.

**Çështja 5 - Operimet ilegale në fushën e minierave dhe mineraleve – Prioritet i lartë**

**E gjetura** Inspektorët e KPMM-së gjatë vitit 2016 kishin identifikuar 40 raste të operimeve ilegale. Gjatë këtij viti KPMM kishte shqiptuar gjoba për operuesit ilegal në vlerë prej 385,603€, duke bërë edhe kallëzim penal për ta në prokurorinë themelore përkatëse. Megjithatë vlera e gjobave të inkasuara ishte minimale prej 24,886€. Mekanizmat aktual për parandalimin e operimeve ilegale dhe inkasimin e gjobave nuk po japin rezultatet e pritura.

**Rreziku** Mos parandalimi i operimeve ilegale mund të ketë për pasojë përdorimin jo të drejtë të pasurive minerale dhe shkatërrimin e mjedisit në natyrë. Në anën tjetër dështimi për të inkasuar gjobat e shqiptuara mund të inkurajojë operuesit ilegal për të vepruar, duke ndikuar edhe në buxhet.

**Rekomandimi 5** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj koordinim efikas ndërmjet mekanizmave shtetërore për të parandaluar plotësisht operimet ilegale. Po ashtu, duhet të shqyrtohet mundësia që inkasimi i gjobave të bëhet përmes përmbaruesve privat si një mekanizëm më efikas në mbledhjen e gjobave, sepse kjo do të ketë ndikim direkt në parandalimin e operimeve ilegale.



### 3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollët kyçë e konfirmojnë saktësinë dhe plotësinë e pagesave të KPMM.

Numri i aprovuar i të punësuarve në KPMM ishte 77, ndërsa numri aktual i të punësuarve në fund të vitit ishte 73 punonjës. Ne kemi rishikuar listat e pagave si dhe kemi krahasuar të dhënat e prezantuara nga Thesari, SIMFK dhe prezantimin e tyre në PFV. Bazuar në këtë konstatojmë se pagat dhe mëditjet ishin menaxhuar në përputhje me legjislacionin.

#### **Rekomandimi**

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

### 3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2016 ishte 367,259€, të cilat edhe ishin shpenzuar. Përderisa buxheti final për shërbime komunale ishte 22,027 kurse ishin shpenzuar 20,931€ apo 95% për pagesën e shërbimeve komunale. Bazuar në testet e bëra në këtë kategori konstatojmë se shpenzimet në këto kategori ishin menaxhuar në përputhje me legjislacionin.

#### **Rekomandimi**

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

### 3.1.4 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 106,858€ i cili ishte shpenzuar në tërësi. Në këtë kategori testuam procedura të prokurimit dhe pagesa, në të cilat nuk kemi konstatuar ndonjë parregullësi.

#### **Rekomandimi**

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

---

## 3.2 Pasuritë

### 3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Sipas PFV-ve dhe regjistrit kontabël të SIMFK-së, vlera neto e pasurive kapitale mbi 1,000€ ishte 1,143,669€, vlera e pasurive jo kapitale nën 1,000€ ishte 64,129€, kurse vlera e stokut 17,160€. Auditimi ynë mbi menaxhimin e pasurisë identifikoi çështjen si në vijim.

---

#### Çështja 6 – Dobësi në menaxhimin e pasurive - Prioritet i mesëm

<b>E gjetura</b>	<p>Në menaxhimin e pasurive kemi identifikuar mangësitë si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Inventarizimi ishte kryer me kohë, mirëpo Komisioni i inventarizimit nuk e kishte numëruar gjendjen e stokut në depo edhe pse kjo parashihet me rregullore 02/2013 për menaxhimin e pasurive; dhe</li><li>• Nuk ishte bërë harmonizimi në mes gjendjes së regjistrave të pasurive dhe gjendjes së dalë nga inventarizimi. Me inventarizim komisioni kishte konstatuar se 122 artikuj (inventar dhe pajisje) në vlerë prej 10,256€ mungojnë. Menaxhmenti nuk kishte ndërmarrë ndonjë veprim shtesë që të konstatoj arsyet e mungesës së pasurive.</li></ul>
<b>Rreziku</b>	<p>Inventarizimi jo i plotë dhe mos harmonizimi i regjistrave me gjendjen e dalë nga inventarizimi, rrisin rrezikun që pasuritë të keqpërdoren, humben apo të tjetërsohen si dhe pasuria e organizatës e pasqyruar në PFV të jetë e mbivlerësuar apo nënvlerësuar.</p>
<b>Rekomandimi 6</b>	<p>Kryesuesi i bordit duhet të sigurojë se janë vendosur kontrollet e duhura të cilat mundësojnë që proceset e menaxhimit të pasurisë janë transparente dhe bëhen në përputhje të plotë me rregullën për menaxhimin e pasurive, duke harmonizuar gjendjen e pasurive me gjendjen e dalë nga inventarizimi.</p>

---

### 3.3 Trajtimi i të arkëtueshmeve

Në fund të vitit 2016, vlera e të arkëtueshmeve ishte 19,030,770€. Prej tyre 7,281,138€ apo 38% e totalit janë borxhe të ndërmarrjes Trepça e cila ishte nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

---

#### Çështja 7 – Rritja e vazhdueshme e të arkëtueshmeve – Prioritet i lartë

**E gjetura** Trendi i të arkëtueshmeve nga viti në vit po shënon rritje. Të arkëtueshmet në vitin 2016 ishin rritur për 2,461,150€ apo rreth 15% në raport me vitin paraprak. KPMM gjatë viteve të fundit ka aplikuar edhe mundësinë e programimit të borxhit me qëllim të lehtësimit të pagesës së borxheve, mirëpo nuk ka dhënë ndonjë rezultat sa i përket përmirësimit në mbledhjen e borxheve të vjetra.

**Rreziku** Niveli i lartë i të arkëtueshmeve dhe jo efikasiteti në mbledhjen e tyre mbeten sfida edhe për periudhën e ardhshme. Mos inkasimi i të arkëtueshmeve rrezikon që ato të bëhen të pambledhshme duke krijuar një rast precedent për borxhlinjtë e tjerë të cilët mund të ndjehen të trajtuar në mënyrë jo të barabartë.

**Rekomandimi 7** Kryesuesi i Bordit duhet të rishikojë politikat dhe rregulloret e KPMM-së me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e borxheve duke marrë të gjitha masat në pajtim me rregulloret dhe ligjin, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet.

### 3.4 Obligimet

Pasqyra e faturave të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2016 ishte vetëm 780€, përderisa ajo në fund të vitit 2015 ishte 17,433€. Pra kemi një zvogëlim të dukshëm të obligimeve krahasuar me vitin paraprak, paraqet një progres pozitiv. Po ashtu, edhe raportimi mujor ishte i plotë dhe i saktë.

#### Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

## Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.1 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Kryetari i Bordit duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuar të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

**Të prioritetit të lartë** - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

**Të prioritetit të mesëm** - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të KPMM.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

## Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

---

*Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit*

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

*Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit*

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

---

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
2.3. Rekomandimet e vitit paraprak	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që plani i veprimit, i rishikuar, të përcaktojë saktë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e rekomandimeve të bëra nga AP për vitin e kaluar.		Nga 10 rekomandimet e dhëna gjashtë (6) ishin zbatuar plotësisht.	
2.4 Lista e vetëvlerësimit të MFK-së.	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se ka hartuar planin strategjik për të mundur monitorimin e progresit dhe vlerësimin e rezultateve të arritura.	Po		
2.5.1 Vlerësimi i rrezikut	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se ka hartuar regjistrin e rreziqeve si operative ashtu edhe financiare si mjete të cilat testojnë efektivitetin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në përkrahjen e objektivave të tyre të punës.	Po		
3.4 Të hyrat	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë ndërmarr masa adekuate për të shtuar përgjegjësinë dhe efikasitetin duke siguruar informata të plota lidhur me vëllimin e mineraleve të prodhuara dhe aktivitetin e shfrytëzuesve të licencave, ashtu siç përcaktohet me kornizën ligjore në fuqi.			Nuk janë marrë masa.
3.4 Të hyrat	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë ndërmarrë masa për forcimin e kontroleve menaxheriale lidhur me licencat, si dhe të siguroj që bartësit e licencave pas skadimit të afatit të kenë fonde të mjaftueshme për rehabilitim e zonave/sipërfaqeve të shfrytëzuara dhe sigurinë ndaj palëve të treta.	Po		



3.4 Të hyrat	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj koordinim sa më të mirë ndërmjet sektorit të inspektoratit, si dhe mekanizmave të tjera përkatëse në mënyrë që të ndikoj në parandalimin e aktiviteteve/operimeve ilegale duke siguruar grumbullim të të hyrave dhe mbrojtjen e interesave të qytetarëve (popullatës vendase).			Nuk janë marrë masa.
3.5 Prokurimi	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se në rast të vonesave të ofrimit të shërbimeve, të aplikohen ndëshkimet.	Po		
3.7. Subvencionet dhe transferet	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj menaxhim më efikas të subvencioneve duke vendosur kontrole përkatëse në zbatimin e plotë të marrëveshjeve për subvencionim.	Po		
3.8.2. Detyrimet e papaguara	Kryesuesi i Bordit duhet të analizoj arsyet për rritjen e obligimeve dhe të siguroj që aktivitetet operative dhe financiare aty ku është e mundur të zhvillohen para muajit dhjetorë. Kjo duhet të bëhet me qëllim që obligimet të mos ngarkojnë buxhetin e vitit vijues.	Po		
3.8.3 Trajtimi i Borxheve	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj ndërmarrjen e masave të duhura, përfshirë veprimet ligjore në mënyrë që të shtoj efikasitetin në inkasimin e parasë publike.			Nuk janë marrë masa.

## Shtojca IV: Letërkonfirmimi



Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosova  
 Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale  
 Nezavisna Komisija za Rudnike i Minerale  
 Independent Commission for Mines and Minerals



### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA			
Zyra Kombëtare e Auditimit			
Nacionalna Kancelarija Revizije / Pristina, Audit Office			
Data: 15.06.2017			
№ i Dokumentit	№ i Aktit	№ i Pjesës	№ i Kopjes
24	24-31	663	1

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft-raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, për vitin 2016 (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- Pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; dhe
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Ramiz Krastiqi

Drejtor i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale,

Data: 15.06.2017, Prishtine

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA	
Zyra Kombëtare e Auditimit	
Nacionalna Kancelarija Revizije / Pristina, Audit Office	
Data: 15.06.2017	
№ i Dokumentit	№ i Aktit
24	24-31
№ i Pjesës	№ i Kopjes
664	1